



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 31.1.2023, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Nora Kelmendi (LVV), Faton Zeka (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Triera Kasumi-Berisha (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Berna Saraçi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Endrit Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Mungoi: Berat Lahu (LVV).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se z. Arbër Vokri për arsye personale, ka dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltarit komunal, kështu që atë e zëvendëson asamblisti i radhës nga GP i LVV-së, z. Faton Zeka.

Faton Zeka e bëri betimin para Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Muhamet Selmani i ftoi të pranishmit për një minutë heshtje në shenjë nderimi me rastin e 26-vjetori të rënies heroike të tre dëshmorëve dhe heronjve të kombit, Zahir Pajaziti, Edmod Hoxha dhe Hakif Zejnullahu.

Përparim Rama, kryetar, propozoi që në rend të ditës të futet pika " Propozimvendimi për emërtimin e rrugës "A" me emrin e z. Xhim Xhema".

Kryesuesi konstatoi se më 41 vota për dhe 1 kundër, u miratua propozimi i kryetarit që, Propozimvendimi për emërtimin e rrugës "A" me emrin e z. Xhim Xhema, hyn në rend të ditës për diskutim.

Me plotësimin e rendit të ditës, kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 38 vota për u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2022 (TM4);
3. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2022;
4. Propozimplan vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2023;
5. Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal;
6. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2023-2025);
7. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 01-202/02-103516/22, dt. 12.05.2022, për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
8. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA në Prishtinë;
9. Diskutim për çështjen e tatimit në pronë;
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 37 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2022 (TM4).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Rashit Gashi tha se fillimi i këtij raporti është pak sa dëshpërues, ku flitet për të hyrat vetanake me një rënie prej 1.36% duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, të hyrat nga taksat për legalizim të ndërtimeve pa leje, të hyrat nga kadastri, të hyra nga inspeksioni etj. kanë shënuar rënie edhe gjatë kësaj periudhe, ku 24% ka rritje të shpenzimeve në paga e mëditje krahasuar me periudhën e njëjtë 2021. Rreth 10 milionë euro për mallra dhe shërbime apo 71% më shumë se në vitin e kaluar, për çka do të dëshironim një shpjegim më të qartë. Gjithashtu, mungon edhe një shpjegim rreth raportit të detyrimeve kontingjente etj.

U konstatua se u përkrah Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2022 (TM4).

Pika e tretë

Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2022.

Arsyeshmërinë për Raportin financiar buxhetor në pika të shkurtra e paraqiti Valbona Makolli, drejtore.

Mirsad Vitia fillimisht tha se ky raport është i punuar në formë amatoreske dhe kjo tregon mosseriozitetin dhe papërgjegjësinë ndaj qytetarëve të kryeqytetit.

Sa i përket performancës së shpenzimeve kapitale të Komunës, ekzekutivi nuk ka arritur të ekzekutojë as 30% të buxhetit të planifikuar. Sa i përket të hyrave vetanake krahasuar me vitin paraprak, shohim se kemi rënie të të hyrave nga kategoritë, siç janë: tatimi në pronë, inspeksioni, mbeturinat, "Hortikultura", taksa për leje ndërtimi, përgjysmim i të hyrave nga legalizimi i ndërtimeve pa leje etj.

Performanca e një qeverisje të mirë, të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse vlerësohet me anë të asaj se si ekzekutivi komunal menaxhon me paranë publike, se si i shpenzon ato mjete dhe sa ua lehtëson jetën qytetarëve në fund të ditës, e jo duke u përpjekur të manipulojë vetën dhe të tjerët.

Mbi 136 milionë euro buxhet për vitin e kaluar, Komuna e Prishtinës ka shpenzuar apo realizuar vetëm 87 milionë euro, duke mos arritur që të shpenzojë mbi 50 milionë, apo rreth

38% të buxhetit të saj. Po ashtu, ky raport paraqet edhe pagesat, ku ka paguar mbi 4.3 milionë euro ndërmarrjen publike lokale "Trafiku Urban" për kompensimin e humbjeve etj. Nga 10 drejtori komunale që i kanë të paraqitura shpenzimet e tyre në projekte kapitale, 9 prej tyre kanë shpenzuar më pak se 50% të buxhetit, por uroj që vërejtjet dhe kritikën tona të ndikojnë, në mënyrë që këtë vit të shohim një dinamikë të shtuar në realizimin e premtimeve të dhëna.

Jeta Rafuna tha se ne të gjithë e dimë se në çfarë gjendje është gjetur Prishtina për 8 vjet keq qeverisje nga ata që qeverisën dhe si e ka gjetur ky ekzekutiv Komunën. Sa i përket shpenzimeve kapitale, të gjithë i dimë sfidat në të cilat kemi kaluar sivjet dhe me gjithë këto sfida e barriera, kemi rritje të investimeve kapitale nga viti paraprak me 5.9%. Po ashtu, një shqetësim tjetër me të cilin është përballur kryetari dhe ekzekutivi, ka qenë bllokimi i OSHP-së, ku si pasojë janë bllokuar shumë projekte kapitale.

Në këtë raport shihet se realizimi i të hyrave vetanake në vitin 2022, është realizim i mirë dhe tejkalon vitin paraprak, ku pritet që në vitin 2023 të ketë tejkallim të planifikimit të të hyrave vetanake për Komunën e Prishtinës.

Leutrim Retkoceri theksoi se ky raport financiar është i mbështetur dhe i bazuar në disa fakte që tashmë janë të njohura edhe për qytetarët, e sidomos për Komunën. Ka qenë një vit i krizës ekonomike dhe si i tillë është i pashmangshëm që raporti të dalë më mirë se me këto shifra që i kemi përpara, por krahasuar me vitin paraprak, kur ka qenë një vit post pandemik, mendoj se ky raport ka vlera dhe shifra inkurajuese të rritjes së performancës së shpenzimeve.

Vlen të ceket se edhe në investimet kapitale kemi një rritje të realizimit të projekteve dhe shpenzimeve, që dallon dukshëm me raportin e parë, të dytë dhe të tretë të tre mujorëve të parë të vitit paraprak. Është inkurajuese që në këtë vit të vështirë të rritjes së çmimeve, bllokimit të OSHP-së dhe të planifikimit të një buxhetit paraprak, është shprehëdhënës dhe inkurajues që raporti i vitit 2023 do të jetë raport i investimeve kapitale.

Bahri Gashi fillimisht kërkoi të dijë se pse ekzekutivi bashkë me kryetarin, nuk i ka bërë disa projekte, por i ka bërë disa të tjera! Fatkeqësisht, këtu është e kundërta dhe neve na paraqitet një raport, ku del se Komuna e Prishtinës ka shpenzuar 64% të buxhetit, e që mendoj se kjo nuk qëndron. Meritor i ekzekutivit qenkan sidomos shpenzimet në paga, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, por aty ku ka nevojë qytetari i Prishtinës në infrastrukturë, d.m.th. është minimalisht 24%, që është shumë e vogël. Gjatë gjithë vitit kemi pasur rast dhe jemi ballafaquar me ankesa dhe kritika nga niveli lokal në raport me Qeverinë në raport me krizën financiare botërore etj. Po ashtu, gjatë gjithë vitit e kemi pasur një përzierje të mundësive, ku kryetari i Komunës është marrë me aktivitete kulturore dhe sportive e nuk janë marrë me ato punë që duhet të merren. Gjithashtu, shumë projekte nuk kanë mundur të tenderohen dhe iu kanë kthyer Komunës së Prishtinës për shkak të kriterëve që ka paraparë Sektori i prokurimit.

Gëzim Mehmeti shprehu mendimin se konstatimi i dhënë nga znj. Rafuna rreth rritjes së shpenzimeve kapitale nuk qëndron, andaj ky ekzekutiv e ka formuluar raportin buxhetor të viti 2021 për shkak të ndryshimit të ekzekutivit. Komuna e Prishtinës shpenzimet kapitale

në vitin 2021 i ka pasur 33.96%, ndërsa në vitin 2022, 27.83 %, ku kemi një diferencë prej - 5.1%.

Endrit Zabërgja fillimisht ceku se realizimi i investimeve kapitale tregon se sa menaxher jeni, derisa statistikisht është dëshmuar që qeverisja e mandatit të kaluar ka qenë më efikase sesa kjo qeverisje, andaj duke e pasur parasysh se sa shumë probleme ekzistojnë në qytetin tonë, konsideroj që është fatkeqësi e madhe që shpenzohen vetëm 27% e investimeve kapitale. Kisha dashur që vitin tjetër ta kemi një buxhet më të madh, duke përfshirë edhe realizimin e projekteve, por nuk mund të ndihemi të kënaqur dhe nuk mund ta vlerësojmë pozitivisht shpenzimin dhe menaxhimin e buxhetit për vitin që e lamë pas.

Gëzim Sveçla tha se nga diskutimet e parafolësve krijohet përshtypje e përgjithshme që kemi të bëjmë me një raport jo të kënaqshëm, natyrisht secili dha arsyetimin nga këndi i vet. Lidhur me këtë raport kam dy çështje konkrete që dua t'i cekë. Te shpenzimet komunale për vitin 2022 janë 230 mijë euro më tepër shpenzime të ujit sesa vitet paraprake, nuk po e di çka ka ndodhur, pse është kjo shumë kaq e rritur. Po ashtu, edhe tek projektet kryesore që disa prej projekteve më të mëdha që kanë vlera më të mëdha, nuk janë projekte që janë realizuar apo kanë filluar, por këto mjete janë përdorur për mbulimin, faktikisht për pagimin e vendimeve gjyqësore, ku si rezultat i kësaj mund të konkludojmë që ato shifra nuk janë të sakta.

Feim Osmani tha se ky raport financiar i cili nuk dallon thuajse aspak nga raporti i vitit 2021, e të cilin bashkërisht e patëm cilësuar si të dështuar apo të dobët, negativ. Ndryshimi i vetëm që unë e vërej, është realizimi deri në shkallën mbi 10% deri në qind për qind tek kategoritë e shpenzimeve, siç janë paga dhe mëditje, komunalit, subvencionet, transferet, kështu që do të thotë se në të gjitha kategoritë ku ka pasur nevojë për planifikim dhe të cilat cilësohen investime, nuk ka realizim të buxhetit as në masën 30%, dhe kjo bënë të kuptojmë se Prishtina po vazhdon trendin e shpenzimit të buxhetit, e jo të investojë apo të menaxhojë ashtu siç ka pritur qytetari, apo edhe siç mund të pretë edhe në vitet në vijim.

Fiknete Bejta tha se ky raport i vitit 2022 është i saktë, që do të thotë se kemi një rritje prej 5.91%. Sa i përket mos arkëtimit, vlerën e dëshirueshme të mjeteve vetanake, duhet ditur se ne jemi në një gjendje ekonomike ku inflacioni llogaritet të jetë mbi 20% për produktet bazike, kështu që kisha sugjeruar që të jemi pak më realistë në diskutimin për gjendjen ekonomike dhe sociale në vend. Sa i përket realizimit të buxhetit, realizimi i buxhetit të shpenzimeve nuk llogaritet vetëm tek realizimi i shpenzimeve kapitale, por duhet të llogaritet në të gjitha kategoritë buxhetore. Tek shpenzimet llogariten shpenzimet buxhetore, që janë në vlerë më shumë 8.91% për vitin 2022 në krahasim me vitin paraprak, shpenzimet për paga dhe mëditje që janë në normë të kënaqshme të ekzekutimit, në vlerë 99.60%, shpenzimet në mallra dhe shërbime, shpenzimet në komunalit, shpenzimet në subvencione, transfere, si dhe shpenzimet kapitale. Lidhur me këtë besoj se do të jetë një vit i suksesshëm në realizimin e projekteve.

Triera Kasumi -Berisha kërkoi të dijë se me çfarë baza krijohet një raport financiar, përderisa ka çalime në transparencën e indikatorëve kryesorë. Përveç atyre që u përmendën këtu, kemi subvencionimin për ndërmarrjet publike, për çka ne në këtë Kuvend i kemi votuar dhe nuk e kemi të dëshmuar në raport. Po ashtu në një mbledhje paraprake kam

ngritur shqetësime mbi listën e detyrimeve kontingjente nga Zyra e përfaqësimit juridik, në të cilën nuk i kemi pasur të detajuara të gjitha lëndët kontingjente, kështu që në këtë raport nuk janë të përfshira, dhe vlerësoj se nuk mund të flas për një raport ose me e votua një raport, i cili çalon në detaje dhe për të cilin kemi planifikime, për të cilat janë raportuar që janë përfunduar e ne nuk e dimë as që ekzistojnë ato.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Valbona Makolli, drejtore.

U konstatua se u përkrah Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2022.

Pika e katërt

Propozimplanin vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2023.

Lidhur me Propozimplanin vjetor të punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2023, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Osman Bllaca.

Nora Kelmendi bëri vërejte lidhur me Planin e punës së Kuvendit, duke thënë se si ta votojmë Planin e punës së vitit 2023, kur nuk e kemi një raport të punës së Kuvendit të vitit 2022, kështu që pa një raport të vitit 2022 nuk po besoj se mund ta votojmë këtë plan të vitit 2023.

Bahri Gashi, lidhur me Planin e punës së Kuvendit bëri vërejtje, duke thënë se në seanca po hyjnë pika të reja, të cilat nuk janë të përfshira edhe në planin e punës.

Ai pyeti se pse kanë hyrë pika të reja vazhdimisht gjatë vitit të kaluara dhe pse do të hyjnë edhe gjatë këtij viti.

Sami Salihu, në cilësinë e anëtarit të grupit punues të këtij plani të punës së Kuvendit, tha se këtë propozimplan e përkrahim për miratim.

Gëzim Sveçla ngriti shqetësim rreth diskutimeve të cilat po bëhen, duke thënë se këto dështime, këto lëshime të cilat po ndodhin, po e ulin nivelin në përgjithësi jo vetëm të diskutimit, por edhe nivelin e punës në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, 4 kundër dhe 14 abstenime, u miratua Plani vjetor i punës së Kuvendit të Kryeqytetit për vitin 2023.

Pika e pestë

Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

Lidhur me Propozimvendimin për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kryetar.

Gëzim Sveçla tha se ne si GP përshëndesim këtë iniciativë të kryetarit dhe inkurajojmë të ketë sa më shumë bashkëpunime të tilla, andaj ne do të përkrahim për miratim.

Pëllumb Bajqinovci tha se ideja për nënshkrimin e një marrëveshjeje të bashkëpunimit ndërkomunal rrjedh nga iniciativa e kryetarit Rama, e paraqitur në Konferencën e parë rajonale, organizuar nga Kryeqyteti, më 11 mars 2022, nga e cila konferencë dolën edhe 17 rekomandime, në mesin e të cilave edhe formimi i një grupi teknik punues për shqyrtimin e bashkëpunimit dhe për përgatitjen e një marrëveshjeje. Grupi punues teknik ka ngritur disa çështjet me interes të Kryeqytetit dhe të pesë komunave me të cilat kufizohet Kryeqyteti.

Korniza ligjore u krijon të drejtën komunave që të hyjnë në bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar, por pa të drejtë të formimit të një niveli të dytë apo të ndërmjetëm.

Bashkëpunimi ndërkomunal bazohet në vullnetin e lirë të komunave për të krijuar marrëdhënie të bashkëpunimit, duke bërë ndarjen e roleve dhe resurseve komunale për nevojat e bashkëpunimit.

Leutrim Retkoceri tha se e përkrahim këtë propozimvendim për bashkëpunim ndërkomunal, dhe inkurajojmë që të ketë bashkëpunime me komunat përreth Prishtinës.

Endrit Gashi u shpreh se edhe ne si GP i AAK-së, e përkrahim këtë iniciativë të kryetarit.

Gëzim Mehmeti tha se edhe ne e përgëzojmë çdo iniciativë të theksuar sa i përket bashkëpunimit ndërkomunal dhe ky propozim në këtë rast është në përputhshmëri të plotë me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës dhe është më se i nevojshëm për shkak të terrenit, reliefit që ka Prishtina.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 37 vota për, u miratua Vendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025.

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Premtime Preniqi, kordinatore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore.

Violeta Salihu tha se ky plan i veprimit për mbrojtjen nga dhuna u realizuar me një punë të përbashkët me mekanizmat koordinues komunalë kundër dhunës në familje, pjesë e të cilit isha edhe unë.

Plani lokal i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje llogaritet një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Prishtinës, i cili u hartua duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardet ndërkombëtare, duke përfshirë këtu Strategjinë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe Programin e Kosovës për barazi gjinore, mbi bazën e së cilës edhe u hartua Plani lokal i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje. Plani i veprimit është i përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e mekanizmit koordinues komunal për mbrojtje nga dhuna në familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre

të përcaktuara në kuadër të marrëveshjes së mirëkuptimit, karshi institucioneve që përfaqësojnë këtë trup institucional dhe përgjegjësive që rrjedhin nga katër shtyllat kryesore të Konventës së Stambollit, që janë:

1. Parandalimi dhe identifikimi i dhunës;
2. Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare;
3. Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave;
4. Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.

Ne si GP i LVV-së e përkrahim miratimin e këtij plani të veprimit dhe mendojmë edhe ta ndryshojmë dhe ta amandantojmë ndonjë aktivitet shtesë gjatë periudhës në vijim.

Elmire Nikçi-Rexha tha se edhe ne e kemi lexuar me seriozitet të madh këtë plan të veprimit dhe e kam parë që objektivat janë shumë ambicioze, po besoj që do të bëhet edhe realizimi i tyre në përpikëri, por e kam një shqetësim, sepse tek disa aktivitete nuk janë paraqitur kostot dhe nuk janë plotësuar me statistika, do të thotë që ka mungesë të disa statistikave rreth informimit dhe disa kostove, andaj ne si LDK e përkrahim këtë iniciativë dhe besoj që do të realizohet.

Leutrim Retkoceri e përgëzoi nënkryetaren, kryetarin dhe të gjithë ata që kanë punuar në këtë plan të veprimit. Kjo është mënyra më e mirë se si një institucion, siç është Komuna e Prishtinës dhe Kuvendi komunal, i përgjigjet një dukurie në kohë jashtëzakonisht të shpejtë, në mënyrë që sadopak të iu ofrojmë grave një strategji dhe plan të veprimit, në mënyrë që Komuna të iu gjendet afër kundër dhunës në familje.

Gëzim Mehmeti falënderoi znj. Premtime Preniqi për angazhimin e saj në formulimin e kësaj çështjeje. Ai tha se unë si anëtar i Komitetit për Barazi Gjinore, në këtë rast e falënderoj kryesuesen e komitetit, e cila me angazhimin e saj ka bërë veprime të dukshme, po ashtu edhe nënkryetarja që ka qenë pjesë e theksuar me ne në angazhim.

Agim Kuleta tha se problemi i dhunës në familje dhe në përgjithësi i dhunës në shoqërinë tonë, është një temë e re për ne, por është problem i vjetër. D.m.th. dhunë ka pasur gjithmonë, mirëpo ka qenë i normuar në një farë mënyre brenda sistemit të udhëheqjes së familjes dhe të shoqërisë në përgjithësi, ka qenë e rehabilituar në atë sistem, është trajtuar si normale, prandaj ne duhet me qenë pjesë të kësaj pjesës progresive që është nisur bashkë, që ta luftojmë pjesën e prapambetur. Ne duhet të merremi me fëmijët tanë, andaj dhe propozoj që kjo të futet tek një nga objektivat specifike, që në shkollat tona fillore të mbajnë një orë mësim në javë lidhur me edukimin dhe sjelljen që duhet ta kenë fëmijët në mesin e tyre dhe në shoqëri.

Lidhur me sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Donjeta Sahatçiu, nënkryetare, dhe Besianë Musmurati, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 41 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për emërtimin e rrugës "A", rruga "Xhim Xhema".

Arsyetimin për emërtimin e rrugës "A", rruga "Xhim Xhema", e paraqiti Përparim Rama, kryetar.

Gëzim Sveçla tha se si GP i LVV-së, këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

Jeta Rafuna tha se edhe GP i LDK-së e përkrah këtë propozimvendim për miratim.

Leotrim Retkoceri theksoi se edhe ne e falënderojmë kryetarin për këtë propozimvendim dhe e përkrahim për miratim.

Kushtrim Mushica tha se edhe ne si GP i AAK-së mendojmë që ky propozim është shumë pozitiv dhe e përkrahim për miratim.

Gëzim Mehmeti theksoi se edhe ne e respektojmë këtë propozim dhe e përkrahim për miratim, duke mos i anashkuar edhe shumë e shumë të tjerë, të cilët kanë kontribuar si në Evropë, SHBA etj.

Endrit Zabërgja në emër të Nismës Socialdemokrate e përkrahim këtë propozim dhe e konsiderojmë si të qëlluar dhe propozimet e tilla do t'i përkrahim gjithmonë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 45 vota për, u miratua Vendimi për emërtimin e rrugës "A", rruga "Xhim Xhema".

Pika e tetë

Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit me numër 01-202/02-103516/22, të datës 12.05.2022, për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Gëzim Sveçla tha se këtë propozim e kemi bërë me qëllim të plotësimit të vendeve të lira në komitetet tjera, me të vetmen arsye për funksionalizim dhe efikasitet sa më të madh.

Në vend të Berat Lahut në Komitetin për Shërbime Publike, emërohet Feim Osmani, në vend të Feim Osmanit në Komitetin për Bujqësi, emërohet Faton Zeka, ndërsa znj. Radije Hoxha emërohet në Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri më 41 vota për, u miratua Vendimi për ndryshimin e vendimit me numër 01-202/02-103516/22, të datës 12.05.2022, për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare, kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, Prishtinë.

Arsyetimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti Valbona Makolli, drejtore.

Gëzim Sveçla, fillimisht u shpreh se ne si LVV, këtë propozimvendim nuk do ta përkrahim dhe do të votojmë kundër, me arsyetimin se po na kërkohet që prej taksave të qytetarit t'i ndajmë 100 mijë euro. Kanë kaluar më se 7 muaj nga ndërrimi i menaxhmentit dhe nuk e

dimë cilat janë rezultatet, ne po vazhdojmë të kërkojmë para shtesë, të kërkojmë subvencione për këtë kompani, nuk e kemi informacionin sa është borxhi ndaj deponisë etj., nga kjo mund të konstatojmë se nëse për 8 muaj një menaxhment nuk arrin që t'i mbledhë 500-600 mijë euro ta shlyej obligimin që ka, atëherë për çfarë plani po flasim, për çfarë vizioni po flasim këtu?! Po ashtu, e kemi edhe një opinion të kundërt të auditimit, që është opinionimi më i keq i mundshëm, ku janë 23 rekomandime. A mund të kemi një përgjigje se çka po ndodh me këto rekomandime, a po zbatohen, ku jemi sot me kompaninë "Pastrimi", apo vetëm do të vazhdojmë kështu të japim para të taksapaguesve pa vizion, pa plan, pa ide.

Jeta Rafuna tha theksoi se ne si GP e përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

Muhamet Selmani, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve në këtë ndërmarrje, tha se ndërmarrja "Pastrimi" është në gjendje shumë të rëndë, vazhdon të jetë e tillë me gjithë kooperimet dhe riparimet e shumta që janë bërë brenda 7 muajve. Mund të them me përgjegjësi të plotë se humbjet në riparime, por edhe në operim të naftës dhe të pajisjeve, tanimë janë në zero. Me gjithë ato pak pajisje që kemi, e kemi marrë ndërmarrjen më 11 kamionë aktivë, sot duhet të jenë diku 16-17 që janë vazhdimisht aktiv në terren, që kemi arritur me i riparuar, megjithatë nuk ka arritur me i menaxhuar borxhet e shumta të grumbulluara. Subvencionimi për të cilin po flasim tani, është i lidhur drejtpërdrejt me një borxh, që është 2 milion euro, që lidhet me KMDK-në, e cila na ka kushtëzuar për një pagesë prej 10% të këtij borxhi për të nënshkruar kontratën për vitin 2023, kështu që ndërmarrja "Pastrimi" nuk i ka këto mjete, andaj është më se i nevojshëm të ndodh kjo, përndryshe ne kemi me u ballafaquar me një situatë, ku kamionët e pastrimit nuk lejohen të futen brenda në deponi dhe kërkoj nga të gjithë ta përkrahni këtë propozimvendim për miratim.

Bahri Gashi theksoi se ndërmarrja "Pastrimi" është në një gjendje jo të mirë, edhe pse që disa muaj kjo administratë e ka marrë në administrim dhe ende nuk kemi parë asnjë rezultat. Ne sot po i japim 100 mijë euro për një nevojë, megjithatë duhet të mendohet edhe për punëtorët e kësaj ndërmarrje që punojnë rrugëve pa asnjë pajisje adekuate. Do të ishte mirë që në këtë drejtim Komuna të marrë ndonjë hap konkret. Duke pasur parasysh gjendjen e atyre punëtorëve, ne kësaj radhe këtë propozimvendim do ta përkrahim për miratim.

Sami Boroci tha se nëse vazhdon ky trend dhe nëse nuk ndërmerren masa konkrete në këtë ndërmarrje, kjo veç ka me vazhduar me u thelluar. Unë edhe në të kaluarën kam qen kundër subvencionimit, sepse mendoj që këto ndërmarrje duhet me qenë ndërmarrje likuide edhe me qenë ndërmarrje të vetëqëndrueshme. Problemi më i madh i kësaj ndërmarrje është se kjo është ndërmarrje rajonale dhe ka shumë problem me arkëtim, ka shumë problem me makineri, kështu që unë besoj se, në një afat sa më të shpejtë, kjo ndërmarrje duhet me u kthyer në ndërmarrje të Prishtinës dhe jo me qenë ndërmarrje rajonale.

Endrit Zabërgja u shpreh se duke pasur parasysh gjendjen e krijuar në këtë ndërmarrje, i bashkëngjitem votimit pro, në kuptimin e asaj që nuk dua ta rëndojë më shumë gjendjen e ndërmarrjes, mirëpo besoj që ekzekutivi duhet të fokusohet për të bërë zgjidhje të veçantë, andaj mendoj që njëherë e përgjithmonë ishte dashtë me u definuar çështja e statutit të kompanisë "Pastrimi".

Violeta Salihu tha se, si anëtare e Kuvendit dhe si qytetare, në emër të shumë qytetarëve paraqes brengat e tyre për gjendjen e mjerueshme që është në disa lagje, ku ka më se dy javë

që nuk janë mbledhur mbeturinat, kështu që edhe në bazë të raportit të auditorit, kanë dalë shumë gjetje, të cilat deri më tash menaxhmenti i ri do të duhej të na tregonte një plan të veprimit se çka është bërë me ato, apo a është ndërmarrë diçka në përmirësimin e atyre gjetjeve, sepse të ndahen mjete përsëri është shumë e pakuptimtë dhe e patolerueshme për Komunën. Në vazhdim ajo para të pranishmëve i lexoi disa nga gjetjet më kryesore të paraqitura në raportin e auditimit.

Hafiz Krasniq shprehu mendimin se përderisa nuk bëhet rajonizimi që kjo ndërmarrje të jetë tipike komunale e Prishtinës, nuk shoh rezultate dhe gjithmonë kemi me u ballafaquar me probleme. Ndërmarrja "Pastrimi" e bën grumbullimin e mbeturinave të një regjioni shumë më të gjerë, kështu sugjeroj që bordi i tanishëm të marrë parasysh këtë element, për ndryshe asnjëherë nuk do të ketë rehati në këtë ndërmarrje.

Feim Osmani tha se duke u bazuar në diskutimet e parafolësve, po vërehet që një kërkesë e kamotshme dhe një përpjekje që pati filluar së paku si ide nga aksionarët për ta rajonizuar ndërmarrjen, nuk kemi informata se a ka vazhduar tutje apo ka ndodhur diçka, si do të realizohet ajo, për arsye se është i komplikuar operimi i kësaj ndërmarrje në këtë formë. Bordi i aksionarëve do të duhej ta paraqiste raportin se çka ka bërë në këtë drejtim dhe në gjitha drejtimet tjera, duke e konsideruar se subvencionet me 100 mijë euro, edhe po që se bëhen çdo gjashtë muaj në këto kriza të thelluara, borxhi veç sa po shkon duke u akumuluar. Kjo nuk është absolut zgjidhje, është menaxhim për një kohë të shkurtër dhe vjen në situata të tilla.

Leutrim Retkoceri theksoi se për ndërmarrjen "Pastrimi", në këtë rast po kërkohet një subvencionim për një borxh të trashëguar dhe për një ndërmarrje që nuk e ka një situatë aspak të mirë dhe nuk e ka pasur asnjëherë. Deponia disa herë bënë veprime të mbylljes së portës për hedhjen e mbeturinave, gjë që kompania e ka të pamundur pastaj të bëjë grumbullime edhe shërbime ndaj qytetarëve.

Borxhet nuk mund të hiqen brenda pak kohësh, as për 7 muaj e as për një kohë të gjatë, andaj duke pasur parasysh se kjo ndërmarrje është rajonale, e cila varet nga katër- pesë komuna të tjera, të cilat kanë një vendimmarrje të jashtëzakonshme në bordin e saj.

Ky subvencionim po bëhet me qëllim për ta lehtësuar atë borxh, pra nuk po subvencionohet kompania, por po subvencionohet borxhi i kompanisë ndaj deponisë.

Triera Kasumi -Berisha tha se përderisa ne nuk kemi pasqyrë reale edhe plane të mirëfillta për menaxhimin e ndërmarrjes, çoftë ato që kanë lëndë përmbartimore, e kanë shuma të vogla të borxheve, e çoftë ato që janë më të mëdha, kjo tregon një keq menaxhim, andaj duhet shikuar se si ka ardhur gjendja e keqmenaxhimit, se nuk është hera e parë, është duke vazhduar njësoj gjendja në këtë ndërmarrje. Konsideroj se nuk është në rregull me kërkuar gjithë kohën subvencionime për të gjitha ndërmarrjet.

Gëzim Mehmeti ngriti shqetësim rreth çështjes procedurale të këtij propozimvendimi, i cili tha se neve na ofrohet vetëm një propozim, i cili ka 3 paragrafë, por mendoj se të gjithë ne që jemi këtu e kemi esenciale çështjen e pastrimit.

Arianit Beqiri shprehu mendimin se kur është rritur buxheti për ndërmarrjen, është dashur të llogaritet pagesa e borxhit. Kamionët janë të rëndësishëm me u ble, por edhe borxhet janë të rëndësishme me u krye, për shkak se kot blen kamion të rinj, kontejnerë të rinj kur nuk kemi ku t'i hedhim mbeturinat, andaj mendoj se këtu varet edhe planifikimi, ndonëse ne kemi dhënë subvencione, kemi ndarë mjete herën e kaluar, prapë borxhi është rritur.

Lidhur me vërejtjet dh sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 15 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare, kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA, Prishtinë.

Pika e dhjetë

Diskutim për çështjen e tatimit në pronë

Gëzim Sveçla theksoi se me vlerësimin e ri të pronave është rritur vlera e pronave të qytetarëve, mbase ky edhe është vlerësim real i pronave, në bazë të çmimeve aktuale të tregut, por që ky vlerësim e këto vlera të reja të na imponohen në një vit dhe në një kohë të rënduar ekonomike dhe financiare. Si Lëvizje Vetëvendosje, pasi kemi analizuar dhe shqyrtuar të gjitha mundësitë që i kemi si në aspektin ligjor, ashtu edhe në aspektin e kompetencave, kemi ardhur në përfundim që mundësia më e mirë, mbase edhe e vetmja, është falja e 100 eurove për të gjithë tatimpaguesit e komunës së Prishtinës. Nëse kjo asamble e voton këtë rekomandim tonin dhe i njëjti zbatohet, atëherë nga ky vendim 85% e taksapaguesve nuk do të paguajnë asgjë për vitin 2023, e atyre që tashmë e kanë bërë pagesën do t'u llogaritet si parapagim për vitin vijues, 10% do të paguanin më pak se 100 euro për vitin 2023, dhe vetëm 5 % e tatimpaguesve do të paguanin më tepër se 100 euro.

Amir Simnica u shpreh se do të ishte mirë që ne si Kuvend komunal t'i propozojmë Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Financave, që të ndryshojnë Ligjin për tatimin ose të merret parasysh që tatimi i këtij viti të bëhet me rregulloren e viteve të kaluara, duke pasur parasysh se jetojmë në një kohë kur çmimet janë ngritur, inflacioni mbi 20%, mirëpo po flasim për diçka që ne nuk kemi kompetencë të vendosim.

Leutrim Retkoceri theksoi se neve më parë na ka ardhur një raport i vlerësimit të pronave nga Ministria e Financave, i cili ka ndikuar në rritjen e tatimit në pronë. Ne si GP i PDK-së,

kërkojmë që tatimi ndaj qytetarëve të mos rritet, raporti të kthehet të shkoj në Kuvend, e që sa më shpejt të bëhet amendamenti për Ligjin e tatimit në pronë dhe Ministria e Financave të marrë një vendim të qartë për raportin e rivlerësimit të pronave, sepse ai raport ka prodhuar edhe rritjen e çmimit. Kjo rritje e çmimit ka qenë paralajmëruar edhe në seancën e 24 nëntorit 2022, kështu që ne nuk përkrahim propozim që nuk ka bazë ligjore. **Bahri Gashi** tha se Qeveria në heshtje e ka bërë vlerësimin për tatimin në pronë dhe në heshtje e ka dërguar në komuna, kështu që edhe në këtë rast Komuna e Prishtinës po më duket që ka heshtur, duke menduar që ka me kaluar në heshtje ky çmim. Ne duhet të bëjmë diçka për këta qytetarë, duhet me ua lehtësuar në çfarëdo lloj varianti të paktën edhe për disa vjet.

Sami Boroci u shpreh se duke pasur parasysh diskutimet që trajtuan çështjen e rritjes së tatimit në pronë, mendoj se disa nga ato nuk qëndrojnë, andaj kisha sugjeruar që nëse ka hapësirë, kisha kërkuar një interpretim ligjor nga Zyra ligjore, që me një vendim të tillë Kuvendi do të mund t'i lironte qytetarët prej shumës 100 euro, atëherë pse duhet bërë politikë dhe mos me i liruar qytetarët nga tatimi në pronë.

Agim Kuleta shprehu mendimin se Qeveria ka mundur ta marrë një iniciativë ligjore për ta ulur normën e tatimit, kështu që me këtë çështje duhet të merret niveli qendrorë, sepse nuk është vetëm problem lokal, por ligji i prek që të gjithë. Pra kjo çështje duhet të zgjidhet me një veprim të Qeverisë, i cili ka efekt në tërë Kosovën e jo në mënyrë parçiale. Mendoj që Kuvendi i Kosovës, me iniciativën e Qeverisë, duhet ta miratojë Ligjin për uljen e normës tatimore, të cilin pastaj secila komunë me kalimin e kohës, në rast se ndryshojnë rrethanat, mund ta përdorin sipas rrethanave dhe ta miratojë Ligjin e amnistisë, me efekt retroaktiv, normalisht për shumën e paguar mbi atë që ka qenë deri tash. Do të dëshiroja që këto dy propozime, si rekomandimet të futen nëse miratohet ndonjë rekomandim nga Kuvendi.

Endrit Zabërgja tha se do të ishte mirë me qenë një presion publik i të gjitha anëve në pezullimin e këtij vlerësimi aktual dhe amendamentin e Ligjit për uljen e normës tatimore, si zgjidhje afatgjate, sepse falja prej 100 euro nuk është një zgjidhje e mirë, andaj kjo tendenca pak a shumë me e rikthyer tash rolin e zgjidhjes në Kuvendin e Kryeqytetit po më duket e padrejtë, sepse Kuvendi i Kryeqytetit nuk është për të gjetur zgjidhjen në këtë situatë, kështu që zgjidhja duhet ardhur nga e ka burimin.

Do të kisha dëshirë të ndihmoja me votën time "për" në faljen e 100 eurove, duke e pasur parasysh gjendjen e qytetarit, mirëpo nëse votoj "për", kjo nuk do të thotë që e konsideroj si zgjidhje, është vetëm duke u bazuar në gjendjen e rënduar socio-ekonomike të qytetarëve. **Feim Osmani** shprehu mendimin se rekomandimi i dhënë nga GP i LVV-së për faljen e 100 eurove, nuk përbën kurrfarë shkelje, mirëpo ne duhet të japim shembull se jemi të gatshëm t'i dalim në ndihmë qytetarit në këto kohë të vështira. Duke marrë për bazë se vlerësimi

është real, besa mund të jetë në disa pjesë edhe prapë nën vlerën reale të tregut, kështu që ne natyrisht duhet të jemi krah i qytetarëve dhe jam që të votohet ky rekomandim dhe ta falim, ta subvencionojmë, është metoda më e mirë dhe propozimi jonë konkret është i qartë, andaj kërkoj edhe një herë që të jemi të vëmendshëm dhe ta përkrahim të gjithë si asamblistë.

Donjeta Dragusha tha se Ministria e Financave mund ta bëjë vlerësimin në një kohë të përshatshme për qytetarët e saj, e jo saktësisht në kohën kur është kriza më e lartë ekonomike. Aktualisht, Komuna e Prishtinës i ka në zbatim normat sikur vitin e kaluar, do të thotë limitet minimale të caktuara me ligj, tani çka mund të bëjë Ministria e Financave është që mund ta pezullojë këtë vlerësim të këtij viti aktual dhe mund të përshpejtojë pak procedurën për Ligjin e tatimit në pronë, sepse prej tetorit 2022, ka një projekt të Ligjit për tatimin në pronë, e që ndoshta kishte me qenë mirë që në projektligj të përfshihet edhe heqja e limitit minimal që e përcakton tatimin.

Arianit Beqiri u shpreh se rekomandimi ynë për Qeverinë e Kosovës, duke u thirru edhe ne si parti e cila në nivel qendror është në pushtet, është për të bërë një fakt të qartë, se ne dëshirojmë që subvencionimi prej 100 euro të ndodh edhe për shkak se vetëm 5 % e popullatës paguajnë mbi 100 euro dhe këtë ide e përkrahim. Pra roli ynë është rol edhe emancipues. Ne duhet të qëndrojmë dhe duhet të proklamojmë politikat të cilat besojmë dhe jo gjithmonë të tërhiqemi, prandaj shpresoj që do të hasim në mirëkuptim dhe ky rekomandim do të votohet.

Gëzim Mehmeti u shpreh në përkrahje të këtij rekomandimi, sepse ka të bëjë me jetën e qytetarëve, por nuk e përkrah momentunin, sepse ka hapësirë ligjore që qytetarët e Kosovës në këtë rast mos ta respektojmë, duke u bazuar në ligjshmërinë, sepse është fakt që ligjshmëria është obligim me u respektuar. Në këtë rast të gjitha partitë që kanë qenë pjesë e Parlamentit 2017/2018, e kanë propozuar, e kanë votuar ndryshimin e ligjit, edhe partia që është tash në pushtet e ka obligim me hapur procedurën e vlerësimit, mirëpo trajtimi është jo i barabartë. Në këtë rast, momentumi nuk është zgjedhur dhe ka mundësi ligjore ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese për pezullim.

Nora Kelmendi shprehu shqetësim lidhur me çështjen e tatimit në pronë, duke thënë se në KPF u pajtuam që për këtë mbledhje të Kuvendit të jetë prezent edhe udhëheqësi i Departamentit të Tatimit në Pronë dhe të na shpjegojë të gjithë procedurën rreth çështjes së tatimit në pronë, mirëpo kjo nuk ndodhi, dhe për këtë kërkoj të dijë arsyen e mos prezencës së tij.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Përparim Rama, kryetar, dhe Alban Zogaj, nënkryetar.

Përparim Rama, kryetar, i propozoi Kuvendit të Kryeqytetit, miratimin e rekomandimeve nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës:

1. Vjelja e tatimit në pronë sipas vlerësimit të ri të pronave, të fillojë nga data 1.1.2024, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për tatimin në pronë;
2. Ndryshimi i Ligjit për tatimin në pronë sipas pikës 1 të këtij propozimi, ia mundëson Kryeqytetit që gjatë vitit 2023, të faturojë dhe të vjelë tatimin në prone sipas vlerave të faturimit të vitit 2022;
3. E inkurajojmë Qeverinë e Kosovës, që nga buxheti qendror të subvencionojë faturat e tatimit në pronë të vitit 2023, në vlerë deri në 100 eurot e para të faturimit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratuan propozimi i kryetarit, z. Përparim Rama.

Gëzim Sveçla, në emër të LVV-së i paraqiti këto rekomandime për miratim:

- Rekomandohet që të bëhet falja prej 100 eurove për të gjithë tatimpaguesit e komunës sonë, nga ky propozim 85% e taksapaguesve nuk do të paguajnë asgjë për vitin 2023, 10% do të paguajnë më pak se 100 euro për vitin 2023, ndërkohë që vetëm 5% e taksapaguesve do të paguajnë më tepër se 100 euro.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për dhe 21 kundër, (me votën e dyfishtë të kryesuesit në këtë rast, që ishte kundër këtij propozimi), nuk u miratua propozimi i dhënë nga z. Sveçla.

**Pika e njëmbëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje.**

Petrit Reçica, për nënkryetaren e Komunës:

- Ku ka mbetur procesi i brendimit?
- Si është menduar të kalohet, kur duhen 2/3 e votave në Kuvend komunal për këtë propozimprojekt?

Rashit Gashi, për kryetarin e Komunës:

- Deri ku ka mbërri procedura rreth premtimit për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit për zonën e Gollakut, dhe kryetari a ka negociuar me ujësjellësin "Prishtina"?
- A jemi diku afër me planet zhvillimore dhe me hartën zonale?

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, përgjigje dhanë Përparim Rama, kryetar, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare dhe Izet Sadiku, drejtor.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina**



Faqe15nga15